

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në mbështetje të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41. /2014, 53/ 16 dhe 83/18), duke vepruar sipas njoftimit të përqendrimit të parashtruar nga **BIG Energia Holdings Kft.**, me seli në rr. Marko 7.6 kati 8, 1055 Budapest, Hungari, përmes Shoqërisë së Avokatëve Apostolska Aleksandrovski dhe Partnerëve nga Shkupi, në seancën e mbajtur më 06.09.2023, solli

### AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me anë të së cilit **BIG Energia Holdings Kft.**, me seli në rr. Marko 7.6 kati 8, 1055 Budapest, Hungari, *synon të fitojë kontroll të pavarur mbi* Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime **DAM ENERXHI SHPK Shkup**, me seli në rr. Ivan Agovski nr.11-1/10, Shkup, përmes shitblerjes së pjesëve, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative ( Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

### Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 09.08.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) është dorëzuar një njoftim i përqendrimit nga **BIG Energia Holdings Kft.**, me seli në rr. Marko 7.6 kati 8, 1055 Budapest, Hungari, ku **BIG Energia Holdings Kft** *synon të fitojë kontroll të pavarur mbi* Shoqërinë për prodhim, tregti dhe shërbime **DAM ENERXHI SHPK Shkup**, me seli në rr. Ivan Agovski nr.11-1/10, Shkup, përmes shitblerjes së pjesëve.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

## **Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:**

**BIG Energia Holdings Kft.** është 100% në pronësi të BIG MEGA OBNOVLIVA ENERGIJA SHPK (në tekstin e mëtejshëm "BIG").

BIG është një shoqëri energjetike që është një prodhuese e pavarur e energjisë dhe operon në Izrael, Rumani, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut. Shoqëria është një filiale e 2 shoqërive publike, BIG SHOPPING CENTERS Ltd. dhe MEGA, që të dyja janë të kuotuar në bursën e Tel Avivit.

Në vitet e kaluara, BIG përmes BIG Energia Holdings Kft. filloi të investojë në sektorin e energjisë elektrike duke blerë pjesë, gjegjësisht shoqëri të tëra, dhe/ose duke zhvilluar projekte të veta.

BIG Energia Holdings Kft. është e pranishme në Maqedoninë e Veriut përmes:

- Shoqërisë për prodhim të energjisë elektrike **BIG MEGA MACEDONIA - SHTIP SOLAR ONE SHPKNJ Shkup**, me seli në rr. Debarca nr.20, Shkup, e cila si aktivitet kryesor ka të regjistruar prodhimin e energjisë elektrike.
- Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime **BIG MEGA MANAXHMENT SHPKNJ Shkup**, me seli në rr. Naum Naumovski - Borçe nr.40, kati 5, lokacioni 8, Shkup, e cila ka të regjistruar si veprimtari kryesor veprimtaritë e menaxhimit.
- **BAKA ENERXHI SHPK Shkup dhe ÇASHICA SOLAR SHPK Shkup**, të dyja me seli në rr. Debarca nr. 20, Shkup, dhe si aktivitet kryesor kanë regjistruar prodhimin e energjisë elektrike.
- **SKAJ SOLAR SHPKNJ Shkup**. me seli në rr. Ivan Agovski nr.11-1/10, Shkup, dhe si aktivitet kryesor ka të regjistruar prodhimin e energjisë elektrike.

DAM ENERXHI SHPK Shkup është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti prioritar i regjistruar i së cilës është prodhimi i energjisë elektrike. Shoqëria është ende në fazën e zhvillimit të projektit për ndërtimin dhe sigurimin e të gjitha licencave të nevojshme për një termocentral për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet diellore-fotovoltaikë, dhe ende nuk ka filluar prodhimin e energjisë elektrike.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1) dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës*

*zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij, veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve*

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

### **Udhëzim për mjetin juridik**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

**KRYETAR**  
**I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS**  
**Prof. Dr. Владимир Наумовски**